



# QENDRA PËR SHËRBIME STUDENTORE DHE KARRIERË

## SHKOLLË VERORE PËR INTEGRIME EVROPIANE - AUSTRI

**Shkolla Verore për Integritime Evropiane** është një aktivitet akademik i organizuar nga **Forumi Evropian "ALPBACH"**. Tema gjenerale e kësaj shkollë verore është: **"Konstruksioni dhe realiteti"**.

### Kush ka të drejtë konkurrimi:

Aplikantët doemos duhet të kenë diplomë universitare ose të jenë në përfundim e sipër të studimeve të tyre. (preferohen drejtimet: drejtësi, ekonomi, shkencat socialo-politike). Shkolla verore do të zhvillohet nga data 19 Gusht - 04 Shtator 2010.

### Vlera e bursës:

Zakonisht bursat mbulojnë vetëm shpenzimet e ndjekjes së kurseve, ndërsa këto bursa për aplikantët nga Evropa Juglindore, Qendrore dhe Lindore do të mbulojnë edhe shpenzimet e akomodimit dhe shpenzimet tjera që dalin nga organizimi i kësaj shkollë verore. Shpenzimet e udhëtimit duhet të mbulohen nga pjesëmarrësit.

### Të gjithë kandidatët e interesuar për aplikim duhet të dorëzojnë këto dokumente:

1. Aplikim për bursë (e gjeni në [www.alpbach.org](http://www.alpbach.org) ose zyrën e **QeSHK**-ut)
2. Biografi të shkurtër (CV)
3. Certifikatë/diplomë ose vërtetim notash për studentë
4. Letër motivimi (opinion i juaj mbi organizimin e forumit "ALPBACH" dhe për euro-integritime)
5. Dy letra rekomandimi nga profesorë relevantë
6. Dëshmi/certifikatë për njohje të gjuhës angleze ose gjermane

Aplikantët duhet të dorëzojnë aplikimin për bursë dhe të gjithë dokumentet tjera në dy kopje, më së voni deri më **16 PRILL 2010** në adresën e forumit evropian "ALPBACH".

**European Forum Alpbach**  
**Non-Profit Foundation under Private Law**  
**Invalidenstrasse 5/7**  
**1030 Vienna**  
**Austria**

**Afati i fundit për aplikim është data: 16 PRILL 2010**

Për informacione më të detajuara drejtohuni në [stipendium@alpbach.org](mailto:stipendium@alpbach.org) ose vizitoni **Qendrën për Shërbime Studentore dhe Karrierë - QeSHK**.